



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court

Prishtinë, 15 tetor 2010
Ref. Nr.: RK 53 /10

VENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 38/09

Radio Zëri i Sharrit

kundër

Vendimit A. nr. 2194/07 të Gjykatës Supreme të Kosovës, i datës 12 shkurt 2009

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Në përbërje të:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, Gjyqtar
Altay Suroy, Gjyqtar
Almiro Rodrigues, Gjyqtar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare
Ivan Čukalović, Gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, Gjyqtare dhe
Iliriana Islami, Gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi është banor i Republikës së Kosovës.

Vendimi i sfiduar

2. Parashtruesi atakon vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr.2194/07, të datës 12 shkurt 2009, dhe që i është shërbyer parashtruesit më 20 prill 2009.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pretendon që vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës përbën shkelje të drejtave dhe lirive themelore, që janë të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm "Kushtetuta"): të drejtat e njeriut, të drejtën e informimit dhe për të qenë i informuar, lirinë e shprehjes, të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit, të drejtën e zhvillimit dhe promovimit." Parashtruesi i kërkesës nuk specifikon cilat janë nenet e Kushtetutës që janë shkelur.
4. Ai për më tepër pretendon se "Gjykata Supreme nuk i përgjigjet atij në lidhje me padinë e tij dhe për këtë arsye më kanë fyer, befasuar dhe dëshpëruar me këtë padrejtësi të dukshme të bërë nga gjyqtarët e këtij institucioni."

Baza juridike

5. Neni 113 (7) i Kushtetutës; Nenet 47 (2), 48 dhe 49 i Ligjit (Nr. 03/L-121) për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 16 dhjetor 2008, (në tekstin e mëtutjeshëm "Ligji") dhe Nenet 54 (b) dhe 69 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm "Rregullorja e Punës).

Procedura para Gjykatës

6. Më 15 shtator 2009, parashtruesi ka dorëzuar Kërkesën në Gjykatë duke kërkuar nga ajo që të vlerësojë kushtetutshmërinë e vendimit A.nr. 2194/07 të Gjykatës Supreme.
7. Më 14 prill 2010 Kolegji Shqyrtues, në përbërje të Gjyqtarëve Kadri Kryeziut (Kryesues), Enver Hasanit dhe Iliriana Islamit, ka shqyrtuar Raportin e Gjyqtarit Raportues Gjyljeta Mushkolaj dhe i ka ofruar një rekomandim Gjykatës në lidhje me papranushmërinë e Kërkesës.

Faktet

8. Më 19 dhjetor 2000, Komisioni i Pavarur për Media (në tekstin e mëtutjeshëm "KPM") i lëshoi Parashtruesit licensën për të transmetuar dhe operuar në Komunitet e Kaçanikut dhe Ferizajt.
9. Më 21 korrik 2005, KPM dhe Parashtruesi arritën një marrëveshje të re për kushtet e funksionimit dhe operimit të transmetimeve të radios duke ndryshuar licencën që ishte lëshuar më 19 dhjetor 2000.
10. Parashtruesi filloi transmetimin në rajonin që ishte përcaktuar me licencën e vitit 2005, por u zhvendos përkohësisht në një lokacion tjetër për shkak se kishte probleme me ndërtesën prej ku operonte dhe transmetonte radion. Ndërsa më 11 qershor 2005, parashtruesi përjetoi rrethana të pakontrollueshme dhe të rënda të forcës madhore (force majeure). Si pajojë, parashtruesi përkohësisht u zhvendos në një lokacion tjetër, që ishte jashtë rajonit të përcaktuar me licencë. Sipas parashtruesit, KPM ishte njoftuar për këtë gjë.
11. Në fillim të nëntorit 2006, KPM është njoftuar që Parashtruesi ka ndërruar lokacionin e transmetuesit dhe në këtë mënyrë më nuk transmetonte nga lokacioni që ishte përcaktuar me licencën e ndryshuar të vitit 2005. Kurse më 6 nëntor 2006, Divizioni për Menaxhimin e Frekuencave (në tekstin e mëtutjeshëm "DMF") i KPM vërejti që parashtruesi që transmetonte nga një lokacion tjetër.

12. Për më shumë, DMF ka vërejtur që koordinatat gjeografike të parashtruesit ishin në mënyrë të konsiderueshme ndryshe nga ato që ishin përcaktuar në licencën e vitit 2005. Në vend që të respektonte koordinatat e frekuencave të përcaktuara në licencë, DMF konstatoi se Parashtruesi përdorte koordinata tjera të frekuencave për dallim prej atyre që i ishin përcaktuar parashtruesit.
13. DMF-ve, duke identifikuar këto parregullsi, më 7 nëntor 2006 i dërgoi një letër parashtruesit duke kërkuar nga ai sqarim në lidhje me ndërrimin e lokacionit dhe të frekuencave.
14. Më 9 nëntor 2006, parashtruesi iu përgjigj DMF-së duke deklaruar që Radio kishte ndërruar lokacionin për shkak të forcës madhore dhe që i njëjti rajon ishte mbuluar në pajtim me licencën.
15. Më 13 nëntor 2006 KPM-ja i dërgoi një letër parashtruesit, duke informuar atë që pa marrë parasysh arsyet e dhëna nga atij, vendimi i parashtruesit për të ndërruar lokacionin pa dorëzuar një kërkesë me shkrim KPM nuk përputhet me licencën e lëshuar më 2005. Për më shumë, KPM-ha kishte kërkuar nga parashtruesi që të rivendoset në Han të Elezit brenda pesë (5) ditëve .
16. Më 10 janar 2007, KPM-ja i dërgoi njoftimin parashtruesit lidhur me shkeljen e kushteve të licencës të lëshuar në vitin 2005.
17. Më 2 mars 2007, pas një mosmarrëveshjeje ndërmjet KPM-së dhe Parashtruesit në lidhje me ndërrimin e lokacionit të Radios, KPM-ja i ofroi atij nënshkrimin e një marrëveshjeje që do të kënaqte të dy palët. Parashtruesi nuk pranoi të nënshkruaj marrëveshjen.
18. Si rezultat, KPM-ja konstatoi që kushtet e licencës ishin shkelur dhe vendosi të shqiptojë masa kundër parashtruesit. Përveç kësaj, parashtruesi ishte urdhëruar të rivendosë antenat dhe të operojë prej lokacionit që ishte përcaktuar me licencën e vitit 2005.
19. Pasi, Parashtruesi nuk u pajtua me masat e shqiptuara nga Bordi i Ankesave për Media i KPM-së. Si pasojë, KPM-ja më 5 qershor 2008 konfiskoi radio transmetuesin e parashtruesit.
20. Më 3 korrik 2008, parashtruesi ngriti padi kundër KPM-së në Gjykatën Komunale të Kaçanikut (C. Nr. 112/08) duke kërkuar nga gjykata që të anuloi vendimin e KPM-së dhe për t'ia kthyer atij pajisjet e radio transmetimit. Mirëpo, Gjykata Komunale në Kaçanik refuzoi kërkesën e parashtruesit
21. Për këtë arsye, Parashtruesi parashtrroi një ankesë në Gjykatën Supreme. Më 12 shkurt 2009, Gjykata Supreme vendosi që padia kundër KPM-së dhe kundër vendimit të Bordit të Ankesave për Media Nr. 0707/0750/MAB/wb ishte e papranueshme. Gjykata Supreme vlerësoi që procedurat e ndjekura para vendimit të KPM-së ishin në pajtim me rregullat e procedurës administrative, që faktet ishin konfirmuar drejtë dhe që e drejta materiale ishte zbatuar drejtë.
22. Më 25 qershor 2009, Kuvendi i Kosovës diskutoi dhe votoi për raportin vjetor të KPM-së për vitin 2008. Disa anëtarë të Kuvendit ngritën dhe diskutuan çështjen e mbylljes së radios. Megjithatë Kuvendi, duke ruajtur natyrën e pavarur të KPM-së, vendosi që mund të debatohet çështje të tilla vetëm pasi që vetë KPM-ja të përgatit një raport me rekomandime.

23. Më 15 shtator 2009, Parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatë duke pretenduar që vendimi i Gjykatës Supreme A. nr. 2194/07 shkel në vijim të drejtat dhe liritë të garantuara me Kushtetutë: të drejtat e njeriut, e drejta e informimit dhe për të qenë i informuar, liria e shprehjes, e "drejta për punë dhe ushtrim të profesionit, e drejta për zhvillim dhe promovim." Megjithatë Parashtruesi nuk specifikon se cilat janë nenet e Kushtetutës që janë shkelur.

Pretendimet e parashtruesit

24. Parashtruesi pretendon që aktivitetet e radios së tij kanë qenë në pajtim me licencën e vitit 2005 dhe se, në veçanti, neni 20 (Lartësia e Antesës së Lokacionit) i licencës së lartëpërmendur lejonte parashtruesin që t'i ngritë antenat deri në 1100 metra. Sipas Parashtruesi i Kërkesës, antenat e radios kanë qenë në lartësi edhe më të ulët se sa që ishte përcaktuar me licencë, prandaj, vendimi i KPM-së për të konfiskuar pajisjet transmetuese dhe ndërprerjen e transmetimit ka shkelur kushtet e licencës dhe po ashtu ligjet e zbatueshme. Ai për më tepër pretendon se, KPM-ja në vendimin e saj të datës 6 prill 2007 theksoi që lartësia e antenës ishte përcaktuar gabimisht, në veçanti, për arsye se një nivel i tillë i lartësisë nuk do t'i lejohej parashtruesit për shkak se një nivel i tillë i lartësisë nuk mund të gjendet në Han të Elezit dhe që licenca shprehimisht përcaktonte koordinatat gjeografike të operimit që mbulojnë vetëm territorin e Hanit të Elezit.
25. Për më shumë, parashtruesi pretendon që ai është dëmtuar nga vendimi i KPM-së dhe prandaj ai kërkon kompensim material në vlerë prej 90.000,00 EURO (nëntëdhjetë mijë euro).

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

26. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë për Kërkesën e Parashtruesit, Gjykata së pari duhet të kontrollojë nëse Parashtruesi ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe më tutje të specifikuara me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e Punës.
27. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet Nenit 49 (Afatet) të Ligjit, që përcakton se:
- "Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi".*
28. Në lidhje me Kërkesën, Gjykata gjen që, vendimi i formës së prerë i Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 12 shkurt 2009, i është dërguar parashtruesit më 20 prill 2009, ndërsa Parashtruesi ka dorëzuar Kërkesën në Gjykatë më 15 shtator 2009. Si rrjedhojë, Kërkesa nuk është parashtruar në Gjykatë brenda afatit kohor të përcaktuar me Nenin 49 të Ligjit.
29. Prandaj, Kërkesa duhet të refuzohet si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të Nenit 49 të Ligjit dhe të Nenit 54 (b) të Rregullores së Punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri:

VENDOS

- I. TA REFUZOJ Kërkesën si të Papranueshme.
- II. Në pajtim me Nenin 20 (4) të Ligjit, ky Vendim do t'iu komunikohet Palëve dhe do të shpallet në Gazetën Zyrtare.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Gjyqja Mushkolaj

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani